



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

12377
Nr. _____ Prot

Shkodër, më 06 09 .2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi "Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me "VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër" të ndryshuar.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: "Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me "VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,



KRYETAR

Benet Beci



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2023

**“PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2023 E MIRATUAR ME “VKB NR. 71,
DATË 27.12.2022 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR, TË NDRYSHUAR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ i ndryshuar; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ; Udhëzimi nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, i ndryshuar; “VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar; VKB nr. 12, datë 20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”; marrëveshjes standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë”, me Nr. 9322 Prot, datë 04.07.2023 si dhe pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën e planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektin të miratuar me “VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar për projektin “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë”, të detajuar si më poshtë: shtesë plani me burim financimi donacion me vlerë 2,335,668 Lekë.

Projekti financohet në kuadër të “Leave No One Behind (LNB) – “Askush të mos mbetet”, udhëhequr dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri – *UNDP Albania*, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për të mbështetur projekte në fushën e shërbimeve shoqërore me bazë komunitare të propozuara nga çdo bashki në Shqipëri.

Buxheti i Projektit i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 2,998,692 Lekë në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Programi (donatori) dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për projektin:

Buxheti i financuar nga Programi (donatori) për Bashkinë Shkodër do të jetë 2,335,668 Lekë (78%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.

Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për Projektin do të jetë 22%, me staf ekzistues për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.

Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesari dhe do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” sipas tabelës së mëposhtme dhe fishës bashkëlidhur.

Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:			
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzi me kapitale
Shuma 2023	1,300,969	314,370	49,999	261,000	675,600
Shuma 2024	1,034,699	892,827	141,872		
Shuma totale e Projektit e financuar nga programi	2,335,668	1,207,197	191,871	261,000	675,600

2. Shtesë e numrit të punonjësve dhe miratimin e nivelit të pagës për punonjësit e planifikuar me fondet e projektit për vitin 2023 dhe 2024.

Në vitin 2023 projekti ka parashikuar të punësojë një punonjës në rolin e Koordinator Projekti dhe Infermier sipas tabelës më poshtë:


Fondi i përllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi mbulohet nga donatori. Koordinator Projekti do të punojë sipas angazhimit: 3 muaj në vitin 2023 dhe 9 muaj në vitin 2024. Ndërsa infermieri do të punojë sipas angazhimit: 3 muaj në vitin 2023 dhe 8 muaj në vitin 2024.

Viti 2023-2024 Punonjës me kontratë që paguhet nga donatori (Për periudhën 12 muaj)

Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist	1		III-b	34,900		
Specialist	1		IV-a	32,700		
Numri i Punonjësve	2					

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Lorena Bardeli

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

Genë Hoxha

Drejtoria e Financës

Blerta Njësle

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse

Adrita Ferri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

RELACION

**“PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2023 E MIRATUAR ME “VKB NR. 71,
DATË 27.12.2022 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PËRFUNDIMTAR 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR, TË NDRYSHUAR ”**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar Këshilltarë!

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; udhëzimi nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, udhëzimit nr. 8, datë 17.2.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donator të huaj, Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017; Programit Askush Të Mos Mbetet Pas, faza e dytë (LNB2) mbështetet mbi përvojën e gjerë të OKB-së në adresimin e përfshirjes sociale dhe nevojave të grupeve të rrezikuara. Projekti mbështet zbatimin e vizionit të sektorit social në Shqipëri, në përputhje me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe aspiratat e vendit drejt integritimit evropian. Qëllimi i fazes së dyte të këtij programi (2021 - 2025) është fuqizimi i personave dhe grupeve të rrezikuara për të pasur akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të thonë fjalën e tyre në vendimmarrje publike që ndikojnë në jetën e tyre dhe të vënë para përgjegjësisë zyrtarët në detyrë; Marrëveshja standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara ‘Askush të mos mbetet pas’ ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë”, me Nr. 9322

Prot, datë 04.07.2023; “VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër”, VKB nr. 12, datë 20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”. Pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, ju dërgojmë këtë relacion “Për miratimin e shtesës së fondeve në buxhetit të Bashkisë së Shkodrës” për Projektin “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë”.

Projekti: “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë” është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Propozimi për ngritjen dhe fuqizimin e shërbimeve ditore për moshën e tretë në territorin e Bashkisë Shkodër vjen si nevojë në rritje për shërbime me bazë komunitare për këtë kategori në strukturat e përkujdesit shoqëror dhe si alternativë ndaj modeleve ekzistuese rezidenciale.

Të dhënat demografike në Shqipëri ashtu si në vendet e tjera europiane flasin për tendencë rritje të jetëgjatësisë së popullsisë, ulje të numrit të lindjeve duke sjellë rritje të numrit të individëve në moshën e tretë. Largimi i vazhdueshëm i të rinjve në kërkim të një të ardhme më të mirë ka sjellë një rritje të të moshuarve, si në të gjithë vendin ashtu edhe në territorin e bashkisë tonë. Me krijimin e Qendrave Komunitare “Për Familjen” dhe gjatë punës tonë në terren, rezultojnë nevoja në rritje të të moshuarve të vetëm, një pjesë e madhe e të cilëve i kanë fëmijët në emigracion. Disa prej tyre jetojnë në situatë shumë të vështirë ekonomike e sociale si rezultat i të ardhurave të ulëta financiare dhe problematikave shëndetësore të moshës.

Gjendja e emergjencës e krijuar nga pandemia COVID-19, gjatë karantinës, na ballafaqoi më tepër me situatën e vështirë të moshës së tretë, të nevojave të tyre për shërbime specifike, për nevojën e tyre për ambiente të përshtatshme për shoqërimin e kalimin e kohës së lirë, dhe në disa raste edhe për shërbime në shtëpi.

Në Qendrat Komunitare “Për Familjen” Nr. 1, 3 dhe 4 do të krijojmë ambiente të përshtatshme për të moshuarit me synim zhvillimin dhe fuqizimin e shërbimeve ditore në komunitet. Ambientet të cilat do të ofrohen nga Bashkia Shkodër, kanë nevojë të mobilohen dhe pajisen për të krijuar hapësira për kalimin e kohës së lirë, aktiviteteve, lojra tavoline, lexim të librave dhe shtypit periodik, TV dhe projektim të filmave. Ndërsa, të pasurit e një këndi me aparate elektronike mjekësore matëse të tensionit, glicemisë, oksigjenit në gjak apo temperaturës ndihmon në kontrollin periodik të parametrave shëndetësore bazike dhe orientimin e të moshuarve drejt vizitave më të specializuara.

Pjesë e rëndësishme e projektit do të jetë krijimi i një skuadre lëvizëse me synim monitorimin e të moshuarve në komunitet, në përbërjen e së cilës do të jenë punonjës social/psikolog dhe infermierë. Specialistët e Qendrave Komunitare “Për Familjen” njohin

të moshuarit në lagjen ose në njësinë administrative që mbulojnë, ndërsa skuadra lëvizëse do të mbështesë rastet më të vështira dhe me nevojë për shërbime në shtëpi.

Kuadri ligjor

Ky projekt do të zbatohet në mbështetje të:

- Ligji nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Planin Social Vendor të Bashkisë Shkodër 2018– 2021 Vendim nr. 84 , datë 20.12.2018.
- Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017.
- Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, nënshkruar më 24 tetor 2016.
- Marrëveshja standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara ‘Askush të mos mbetet pas’ ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë”, me Nr. 9322 Prot, datë 04.07.2023.

Kuadri i përgjithshëm

Programi Askush Të Mos Mbetet Pas, faza e dytë (LNB2) mbështetet mbi përvojën e gjerë të OKB-së në adresimin e përfshirjes sociale dhe nevojave të grupeve të rrezikuara. Projekti mbështet zbatimin e vizionit të sektorit social në Shqipëri, në përputhje me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe aspiratat e vendit drejt integritimit evropian. Askush Të Mos Mbetet Pas (LNB2) shfrytëzon ekspertizën teknike dhe njohuritë e agjencive të OKB-së që synojnë ndikim dhe shtrirje më të madhe duke u fokusuar në nivel bashkie dhe në organizmat respektiv në nivel kombëtar. Qëllimi i fazes së dytë të këtij programi (2021 - 2025) është fuqizimi i personave dhe grupeve të rrezikuara për të pasur akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të thonë fjalën e tyre në vendimmarrje publike që ndikojnë në jetën e tyre dhe të vënë para përgjegjësisë zyrtarët në detyrë.

Meqenëse ofrimi i shërbimeve realizohet kryesisht në nivel lokal, edhe ndërhyrja fokusohet në nivel lokal. Dy prej tre rezultateve pasqyrojnë këtë shtysë - duke fuqizuar përfituesit në nevojë për masa për mbrojtje sociale për të pasur akses dhe për të kontribuar në përfshirjen e tyre sociale (rezultati 1), dhe duke i aftësuar bashkitë të ofrojnë shërbime dhe të promovojnë mbrojtjen dhe përfshirjen sociale (rezultati 2). Rezultati i tretë pasqyron qëllimin e projektit për ankorimin e ndërhyrjeve të tij në nivel sistemi; që është kontributi në hartimin dhe zbatimin e mëtejshëm të politikave të përshtatshme për përfshirjen sociale, përfshirë edhe financimin.

Në këtë linjë edhe Bashkia Shkodër është shpallur fituese e thirrjes me projektin “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë”.

Planifikimi strategjik i shërbimeve të kujdesit social në Shkodër është bazuar në prioritetet dhe nevojat kryesore për shërbime të kujdesit shoqëror, të përcjella nga vetë komuniteti dhe aktorë kyç të Bashkisë. Ndaj vizioni i Bashkisë Shkodër në këtë drejtim është: “Shërbime sociale multisektoriale të qëndrueshme dhe të standardizuara pranë komunitetit në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”. Bazuar edhe në Planin Social, Bashkia Shkodër ka për qëllim të përmbushë nevojat për mbrojtje, perkujdesje, rehabilitim, përfshirje sociale dhe riintegrim të individëve, duke synuar një komunitet me familje dhe individë të mbrojtur dhe të fuqizuar.

Në këtë kuadër, **qëllimi i përgjithshëm** i projektit është: Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale me bazë komunitare të qëndrueshme dhe të standardizuara në mbështetje dhe përfshirje të moshës së tretë, që synojnë e tyre, rritjen e aksesit në shërbime dhe mundësi, me qëllim final promovimin e përfshirjes sociale të tyre.

Buxheti i Projektit:

Buxheti i Projektit për Bashkinë Shkodër do të jetë 2,998,692 Lekë në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Programi dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për projektin:

- Buxheti i financuar nga Programi për Bashkinë Shkodër do të jetë 2,335,668 Lekë (78%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.
- Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për Projektin do të jetë 663,024 Lekë (22%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Bashkia Shkodër do të bashkëfinancojë projektin me burimet e veta, sipas zërave: Paga dhe sigurime (staf ekzistues që ndjek projektin) për projektin 663,024 Lekë dhe bashkëfinancimi do të mbulohet nga burimet ekzistuese dhe nuk kërkon kosto shtesë për financim.

Burimet Njerëzore

Shtesë e numrit të punonjësve dhe miratimin e nivelit të pagës për punonjësit e planifikuar me fondet e projektit për vitin 2023 dhe 2024.

Në vitin 2023 projekti ka parashikuar të punësojë një punonjës në rolin e Koordinator Projekti dhe Infermier sipas tabelës më poshtë:

Fondi i përlllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi mbulohet nga donatori. Koordinator Projekti do të punojë sipas angazhimit: 3 muaj në vitin 2023 dhe 9 muaj në vitin 2024. Ndërsa infermieri do të punojë sipas angazhimit: 3 muaj në vitin 2023 dhe 8 muaj në vitin 2024.

Viti 2023-2024 Punonjës me kontratë që paguhet nga donatori (Për periudhën 12 muaj)

Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist	1		III-b	34,900		
Specialist	1		IV-a	32,700		
Numri i Punonjësve	2					

Objektivi i përgjithshëm i projektit

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është: Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale me bazë komunitare të qëndrueshme dhe të standardizuara në mbështetje dhe përfshirje të moshës së tretë, që synojnë e tyre, rritjen e aksesit në shërbime dhe mundësi, me qëllim final promovimin e përfshirjes sociale të tyre.

Aktivitetet kryesore të projektit

Aktiviteti 1) *Krijimi, pajisja dhe mobilimi i përshtatshëm i ambienteve për të moshuarit pranë Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 1, 3 dhe 4.*

Aktiviteti 2) *Ofrimi i shërbimeve në banesë i të moshuarve të braktisur dhe më në vështirësi ekonomike e sociale me anë të skuadrës lëvizëse.*

Aktiviteti 3) *Shërbime informimi/këshillimi/orientimi, argëtimi dhe kalimi të kohës së lirë pranë hapësirave Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 1, 3 dhe 4 për të moshuarit.*

Rezultatet kryesore të pritshme të projektit

Rezultati 1: Tre (3) Qendra Ditore për të moshuar, të pajisura dhe funksionale, pranë Qendrave Komunitare „Për Familjen“ Nr. 1, 3 dhe 4 të Bashkisë Shkodër.

Treguesit:

- Përgatitja e procedurave të tenderimit për mobilim dhe pajisje.
- Mobilimi dhe pajisja e Qendrave.
- 250 të moshuar përfitues të shërbimeve dhe frekuentues të ambienteve.

Rezultati 2: Shërbime të lëvizshme në banesë dhe të bashkërenduar me institucionet e tjera publike e private për të moshuarit më në vështirësi.

Treguesit:

- 1 skuadër lëvizëse.
- 2 persona të zgjedhur sipas termave të referencës të përcaktuar.
- Pajisje elektronike për matjen e parametrave shëndetësore.

Rezultati 3: Shërbime ditore fuqizuara për të moshuarit që frekuentojnë Qendrat Komunitare "Për Familjen".

Treguesit:

- Të moshuar më aktivë dhe të përfshirë në aktivitete sociale.
- Të moshuar të informuar dhe ndërgjegjësuar rreth tematikave të ndryshme sociale dhe shëndetësore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik

Lorena Beqalari



Nr.	Projekti: P10430.Q2.O1.A8 "Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë"	Funksioni: 10: MBROJTJA SOCIALE N/Funksioni 104: Familja dhe fëmijët Lloji i programit 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Kuadri i përgjithshëm:		
<p>Bashkia Shkodër është shpallur fituese me projektin "Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë" është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte "Askush të Mos Mbetet Pas", një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Nëpërmjet këtij projekti synohet të financohet Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale me bazë komunitare të qëndrueshme dhe të standardizuara në mbështetje dhe përfshirje të moshës së tretë, që synojnë e tyre, rritjen e aksesit në shërbime dhe mundësi, me qëllim final promovimin e përfshirjes sociale të tyre.</p>		
<p>Programi Askush Të Mos Mbetet Pas, faza e dytë (LNB2) mbështetet mbi përvojën e gjerë të OKB-së në adresimin e përfshirjes sociale dhe nevojave të grupeve të rrezikuara. Projekti mbështet zbatimin e vizionit të sektorit social në Shqipëri, në përputhje me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe aspiratat e vendit drejt integritit evropian. Askush Të Mos Mbetet Pas (LNB2) shfrytëzon ekspertizën teknike dhe njohuritë e agjencive të OKB-së që synojnë ndikim dhe shtrirje më të madhe duke u fokusuar në nivel bashkie dhe në organizmat respektiv në nivel kombëtar. Qëllimi i fazes së dytë të këtij programi (2021 - 2025) është fuqizimi i personave dhe grupeve të rrezikuara për të pasur akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të thonë fjalën e tyre në vendimmarrje publike që ndikojnë në jetën e tyre dhe të vënë para përgjegjësisë zyrtarët në detyrë.</p>		
<p>Meqenëse ofrimi i shërbimeve realizohet kryesisht në nivel lokal, edhe ndërhyrja fokusohet në nivel lokal. Dy prej tre rezultateve pasqyrojnë këtë shtysë - duke fuqizuar përfituesit në nevojë për masa për mbrojtje sociale për të pasur akses dhe për të kontribuar në përfshirjen e tyre sociale (rezultati 1), dhe duke i aftësuar bashkitë të ofrojnë shërbime dhe të promovojnë mbrojtjen dhe përfshirjen sociale (rezultati 2). Rezultati i tretë pasqyron qelimin e projektit për ankorimin e ndërhyrjeve të tij në nivel sistemi; që është kontributi në hartimin dhe zbatimin e mëtejshëm të politikave të përshtatshme për përfshirjen sociale, përfshirë edhe financimin.</p>		
Kuadri ligjor:		
<p>Ky projekt do të zbatohet në mbështetje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" - Planin Social Vendor të Bashkisë Shkodër 2018– 2021 Vendim nr. 84 , datë 20.12.2018. - Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017. - Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, nënshkruar më 24 tetor 2016. - Marrëveshja standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara 'Askush të mos mbetet pas' ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit "Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë", me Nr. 9322 Prot, datë 04.07.2023. 		
<p>Buxheti i Projektit për Bashkinë Shkodër do të jetë 2,998,692 Lekë në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Programi dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për projektin:</p>		
<ul style="list-style-type: none"> • Buxheti i financuar nga Programi për Bashkinë Shkodër do të jetë 2,335,668 Lekë (78%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. • Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për Projektin do të jetë 663,024 Lekë (22%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. 		
<p>Bashkia Shkodër do të bashkëfinancojë projektin me burimet e veta, sipas zërave: Paga dhe sigurime (staf ekzistues që ndjek projektin) për Projektin 663,024 Lekë dhe bashkëfinancimi do të mbulohet nga burimet ekzistuese dhe nuk kërkon kosto shtesë për financim.</p>		
<p>Koordinatori i projektit dhe infermieri janë dy figurat profesionale që do të paguhen nga projekti për 12 muaj për koordinatoren dhe 11 muaj për infermierin.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<p>Qëllimi i përgjithshëm i projekt-propozimit është: Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale me bazë komunitare të qëndrueshme dhe të standardizuara në mbështetje dhe përfshirje të moshës së tretë, që synojnë e tyre, rritjen e aksesit në shërbime dhe mundësi, me qëllim final promovimin e përfshirjes sociale të tyre.</p>		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<p>Aktiviteti 1) Krijimi, pajisja dhe mobilimi i përshtatshëm i ambienteve për të moshuarit pranë Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 1, 3 dhe 4.</p>		

<p>Aktiviteti 2) Ofrimi i shërbimeve në banesë i të moshuarve të braktisur dhe më në vështirësi ekonomike e sociale me anë të skuadrës lëvizëse.</p> <p>Aktiviteti 3) Shërbime informimi/këshillimi/orientimi, argëtimi dhe kalimi të kohës së lirë pranë hapësirave Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 1, 3 dhe 4 për të moshuarit.</p>						
b) Rezultatet që prisni						
<p>Rezultati 1: Tre (3) Qendra Ditore për të moshuar, të pajisura dhe funksionale, pranë Qendrave Komunitare „Për Familjen“ Nr. 1, 3 dhe 4 të Bashkisë Shkodër.</p> <p>Treguesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përgatitja e procedurave të tenderimit për mobilim dhe pajisje. -Mobilimi dhe pajisja e Qendrave. -250 të moshuar përfitues të shërbimeve dhe frekuentues të ambienteve. <p>Rezultati 2: Shërbime të lëvizshme në banesë dhe të bashkërenduar me institucionet e tjera publike e private për të moshuarit më në vështirësi.</p> <p>Treguesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> -1 skuadër lëvizëse. -2 persona të zgjedhur sipas termave të referencës të përcaktuar. - Pajisje elektronike për matjen e parametrave shëndetësore. <p>Rezultati 3: Shërbime ditore fuqizuara për të moshuarit që frekuentojnë Qendrat Komunitare "Për Familjen".</p> <p>Treguesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të moshuar më aktivë dhe të përfshirë në aktivitete sociale. -Të moshuar të informuar dhe ndërgjegjësuar rreth tematikave të ndryshme sociale dhe shëndetësore. 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> • Autoritetet vendore & lokale; • Nëpunësit e qeverisjes lokale, • Organizatat e shoqërisë civile, • Media lokale, • Komuniteti në përgjithësi. 			Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), UNDP Albania, UNICEF, UN Women, UNFPA.			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime shoq + shend.	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për Projektin (2 punonjës)	364.4	314.4	50		
A.2	Blerje paisje zyre (mobilim + kondicionera)	675.6				675.6
A.3	Blerje paisje mjekësore (matës tensioni, diabeti, oksimetër, fisha diabeti, kuli e ndihmës së shpejtë etj)	225			225	
A.4	Blerje Materiale promovionale (Dizenjim dhe printim i materialeve promovionale dhe të vizibilitetit, Roll up i projektit, fletëpalosje, stilolapsa etj)	36			36	
Shuma		1,301	314.4	50	261	675.6
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime shoq + shend.	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale
A.1	Paga dhe sigurime për Projektin (2 punonjës)	1,035	893	142		
Shuma		1,035	893	142		
f) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			
2023-2024			Drejtoria e Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik			
			Institucioni llikujdues: Bashkia Shkodër			